


02 75920
20.08.25



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Njësia për Menagjimin e Burimeve Njerëzore

Në përputhje me dispozitat e nenit 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Vendimi Nr. 10/XII/2024 datë 26.12.2024 të Ministrisë së Shëndetësisë si dhe Rregullorja (QRK)-Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimet të Nëpunësve të shërbimit publik në Sektorin e Shëndetësisë, Komuna e Gjilanit publikon:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës:

Zyrtar/Kordinator për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore në QKMF „Dr. Nagip Rexhepi” Gjilan

Numri i pozitave: Një (1)

Institucioni : Komuna e Gjilanit

Drejtoria : DSHMS-QKMF

Titulli i mbikëqyrësit :Drejtori i QKMF-së

Koeficienti : 6.6

Orari i punës : 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës : me kohë të pacaktuar

Periudha provuese : 6 (gjashtë) muaj

Detyrat dhe përgjegjësit për zyrtarin/kordinatorin për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore (përshkrimi i shkurtër):

- Harton planin institucional të SMC sipas kornizës së aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe monitoron zbatimin e planit të SMC në përmirësimin e performancës.
- Bashkëpunon me udhëheqësin e institucionit shëndetësor në caktimin e komitetit të cilësisë, komisioneve tjera si atë për audit klinik dhe hulumtim, organizim të shqyrtimit kolegjial dhe të ngjashëm, të përcaktuar me statut apo akte nënligjore.
- Merrë pjesë në takimet e menaxhmentit dhe të komitetit të cilësisë dhe ofron këshillime dhe rekomandime për trupat menaxhues, kordinatorin për zhvillim të vazhdueshëm profesional , profesionistët shëndetësor dhe bashkëpunëtorët shëndetësor me qëllim të zbatimit të standardeve sipas SMC.
- Përcjell zhvillimet e reja në SMC, evidenton nevojat për përmirësim dhe menaxhon dosjet për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore për institucionin shëndetësor.

- Njofton për miratimin e Udhërrëfyesve klinik,protokolleve klinike,udhëzueseve, procedurave standarde operative si dhe dokumenteve tjera për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore dhe monitoron zbatimin e tyre në institucionin shëndetësor (QKMF).
- Vlerëson në mënyrë periodike fazën e zbatimit të planit të SMC së shërbimeve shëndetësore dhe nivelin e përputhshmërisë me standardet dhe kërkesat e monitorimit të nxjerra nga Departamenti i cilësisë, sigurisë,akreditimit dhe licencimit të institucioneve shëndetësore në MSH.
- Incidentet kritike në veprimtarinë e institucionit shëndetësor i raporton menjëherë në kompetencë.
- Raporton në baza javore,mujore,tre mujore,vjetore dhe sipas komitetit për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore dhe mbanë në dijeni udhëheqësin e institucionit shëndetësor.
- Raporton në baza tre mujore,vjetore dhe sipas kërkesës përmes udhëheqësit të institucionit shëndetësor në Departamentin e cilësisë,sigurisë akreditimit dhe licencimit të institucioneve shëndetësore në MSH.

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta :

- 1.Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 2.Të ketë zotësi të plotë për të vepruar *(dëshmia prezantohet nga kandidati nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatet e arritura)*.
- 3.Të jetë i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- 4.Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
5. Të mos jetë i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje(*dëshmia prezantohet nga kandidati nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatet e arritura*) ;
6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
7. Të ketë arsimin,përvojën e punës profesionale dhe /apo aftësitë e krijuara për pozitën; kategorinë, klasën apo grupin përkatës dhe
8. Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në Ligjin për zyrtar Publik.

Kualifikimi profesional, përvoja e punës,aftësitë:

Përgaditja e lartë (bachelor) nga lëmia e shëndetësisë;

Të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune pas diplomimit;

Licenca e punës;

Aftësi për t'iu përshtatur prioritetëve dhe kërkesave brenda afateve kohore dhe zgjidhjes së problemeve;

Aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi.

Dokumentet e nevojshme :

1. Formulari i aplikimit i plotësuar
- 2.Diploma Bachelor nga lëmia e shëndetësisë (kopje të noterizuar),
- 3.Licenca e punës;
- 4.Përsonat me diplomë jashtë vendit duhen ta kenë të nostifikuar nga MASHT,
- 5.Rezumeja personale-CV,

5. Certifikatën e lindjes (origjinale),
6. Letënjoftimin apo pasaporta (kopje),
7. Certifikatën e gjendjes shëndetësore (pas përzgjedhjes nga Komisioni).

Sqarim shtesë:

Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (dhe jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi). Komuniteti jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrat Publik.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Testi me shkrim vlerësohet me 70 pikë (kalueshmëria 50 pikë)
Intervista vlerësohet me 30 pikë

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Data e njoftimit **.20.08.2025.**

Data e aplikimit prej datës **.21.08.2025 deri më datën .19.09.2025. ora 16:00**

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë.

Të gjithë kandidatët/aplikantët e interesuar aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, apo t'i shkarkojnë nga Web faqja zyrtare e Komunës së Gjilanit **<https://kk.rks-gov.net>, ti plotësojnë në mënyrë elektronike dhe së bashku me dokumentacionin** përkatës të dorëzohen në **QSHQ**. (Drejtoria për Administratë të Përgjithshme).

Në aplikacion të shënohet saktë pozita për të cilën aplikon kandidati.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet me dokumente të pakompletuara do të refuzohen.

Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.

Dokumentet dorëzohen në kopje fizike dhe të njëjtat pas përfundimit të procedurave të rekrutimit nuk kthehen.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në testin me shkrim dhe ata që vlerësohen në testin me shkrim do të ftohen në intervistë.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimit i cili do të publikohet në web faqen e Komunës së Gjilanit, tabelën e Qendës Kryesore të Mjekësisë Familjare „Dr. Nagip Rexhepi” në Gjilan.

Rezultatet e testit me shkrim dhe ato përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit **<https://kk.rks-gov.net/Gjilan/>** dhe në linkun **<https://konkursi.rks-gov.net/>**.